

VENDIM
Nr. 310, datë 15.5.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 12.2.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË
DOKUMENTACIONIT E TË PROCEDURËS PËR PAJISJEN, REFUZIMIN,
RIPËRTËRITJEN DHE ANULIMIN E LEJES SË PUNËS TË TIPIT “C””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 71, pika 8, 86, pika 2, dhe 132, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “c”, e pikës 4, të vendimit nr. 78, datë 12.2.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) kopjen e pasaportës, për kategoritë e përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” e “d”, të nenit 101, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar, ose në mungesë të saj një dokument identifikimi, të verifikuar dhe të konfirmuar nga Ministria e Brendshme.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme dhe strukturat në varësi të tyre për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe